



Pranuar / Dorezuar Priljevit/Prilato Received/Delivery	26.04	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKUMSHICK	2429/2022		1/3	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.239/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.239/2022 të datës 16.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 26.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.239/2022 e datës 16.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në pozitën Ekspert i GIS-it sipas Akt emërimit të datës 30.12.2011, me datë 16.03.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1413/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore që organi i punësimit Agjencia Kadastrale e Kosovës ti bëjë kompensimin e shpenzimeve për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes (nënës).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 23.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia Kadastrale të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 01.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokoli 1777/2022, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës faqe 1/11.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 1431/2022 të datës 16.03.2022, përmes e-mailit parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 27.01.2022 përmes e-mailit; Kërkesë



për pagesën shtesë me rastin e vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes; Opinion ligjor i datës 03.02.2022; Përgjigje nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik e datës 04.02.2022; Kërkesë për pagesën shtesë me rastin e vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes e datës 01.02.2022; Çertifikatë e vdekjes e datës 30.09.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 01.04.2022 me nr.protokolli 1777/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi i datës 30.12.2011; E-mail zyrtar i datës 06.01.2022; E-mail zyrtar i datës 02.03.2022; E-mail zyrtar i datës 04.02.2022; E-mail zyrtar i datës 11.01.2022 dhe E-mail zyrtar i datës 06.01.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit


*sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas Akt Emërimit datës 20.12.2011, konstatohet se ankuesi është i punësuar në Agjencinë Kadastrale e Kosovës/MMPHI, në pozitën e punës Ekspert i GIS-it. I njëjti me datë 06.01.2022 ka bërë kërkesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për pagesën e shpërblimit jubilar dhe Kërkesën për pagesën shtesë me rastin e vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes. Ndërsa, me datë 02.02.2022 Menaxherja e Departamentit të Burimeve Njerëzore ka bërë kërkesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, kërkesës ja ka bashkangjitur edhe Çertifikatën e vdekjes së nënës së ankuesit të datës 27.10.2016. Me datën 04.02.2022 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka kthyer përgjigje për Menaxheren e Departamentit të Burimeve Njerëzore. Menaxherja e Burimeve njerëzore me datën 02.03.2022 ka njoftuar ankuesin se kërkesa për pagesën e shpërblimit jubilar është pranuar, duke u bazuar në nenin 22 paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku përcaktohet pagesa e *shpërblimi i përojetorit (jubile)*, ndërsa lidhur me kërkesën për pagesën shtesë me rastin e vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes DMZP ka dhënë opinionin ligjor "Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil në nenin 22 ndihma për familjen në rast të vdekjes së nëpunësit civil dhe vdekjes së një anëtari të ngushtë të nëpunësit civil, gjegjësisht në paragrafin 2 thotë: "sipas nenit 22 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në shërbimin civil".

Në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 neni 87 afati i parashkrimit thuhet: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", përfundon opinionin ligjor i DMZP-së.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet se "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili kërkon që t'i behët kompensimi në rastin e vdekjes së nënës së tij, dhe mbi këtë bazë të specifikuar më lartë konstaton se kërkesa e ankuesit është e pabazuar.

Se kush përbënë familjen, Kolegji ju referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: "Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij



ligji". Lidhur me këtë, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, ndërsa përkundër që nuk ka ndonjë efekt sa i përket vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë për shkak të parashkrimit të kërkesës, por se kolegji me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk ka hasë në certifikatë të bashkësisë familjare ku konfirmohet se ankuesi ka qenë në bashkësi familjare me nënën e tij.

Mbi këtë bazë, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatës së Vdekjes me Nr. serik V 10444447 të datës 30.09.2021, konstatohet se gjegjësisht nëna e ankuesit ka ndërruar jetë me datë 27.10.2016, kështu që duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil dhe të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së nënës është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.239/2022, datë 26.04.2022

Sabile AVDYLI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



### Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës/MMPHI;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kadastrale të Kosovës/MMPHI dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së